



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit*  
*Ministarstvo za Saobracaj Postu i Telekomunikacije*  
*Ministry of Transport and Communications*

---

**RREGULLORJA Nr. 2008/4**  
**MBI PËRGJEGJËSINË E TRANSPORTUESIT AJROR LIDHUR ME TRANSPORTIN**  
**E UDHËTARËVE DHE BAGAZHIT TË TYRE PËRMES AJRIT**

**Ministri,**

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007,

Në pajtim me Nenin 6.1 të Ligjit mbi Aviacionin Civil (Ligji Nr. 03/L-051) të datës 13 Mars 2008,

Duke pasur parasysh nënshkrimin nga ana e UNMIK-ut të Marrëveshjes Multilaterale mbi Krijimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (“Marrëveshja HPEA”) në emër të Kosovës dhe hyrjes së përkohshme në fuqi të Marrëveshjes së HPEA-së në Kosovë më datën 10 Tetor 2006,

Duke pasur parasysh dispozitat e Konventës për Unifikimin e Rregullave të Caktuara për Transportin Ajror Ndërkombëtar (Montreal, 1999) për të gjitha kontratat e transportit ajror të udhëtarëve, bagazhit dhe ngarkesës ku Kosova është pikë fillestare, pikë e destinacionit ose vendi për tu ndalur i pajtuar, janë deklaruar të aplikueshme në Kosovë përmes Ligjit mbi Aviacionin Civil (Ligji Nr. 03/L-051) të datës 13 Mars 2008,

Me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave për përgjegjësinë e transportuesit ajror lidhur me transportimin e udhëtarëve dhe bagazhit të tyre përmes ajrit në pajtim me Marrëveshjen e HPEA-së dhe kërkesës së saj që Rregullorja (EC) Nr 2027/97 i ndryshuar me Rregulloren (EC) Nr 889/2002 të bëhet pjesë e rregullave të brendshme ligjore të Kosovës

Me anë të kësaj lëshon Rregulloren në vijim:

## **Neni 1**

Kjo Rregullore implementon dispozitat përkatëse të Konventës Montreale lidhur me transportimin e udhëtarëve dhe bagazhit të tyre përmes ajrit ku Kosova është pikë fillestare (e origjinës), pikë e destinacionit apo vend për tu ndalur sipas marrëveshjes dhe parashtron disa dispozita plotësuese. Gjithashtu, e zgjeron zbatimin e këtyre dispozitave për transportin ajror edhe përbrenda Kosovës.

## **Neni 2**

### **Përkufizimet dhe Interpretimi**

1. Në këtë Rregullore:

“Transportues ajror” do të thotë një ndërmarrës transporti ajror me licencë valide për operim;

“Marrëveshja HPEA” do të thotë Marrëveshja Multilaterale në mes të Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të saj, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë mbi Krijimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit;

“Transportues ajror i HPEA-së” do të thotë një transportues ajror i cili është i licencuar si kërkohet nga Marrëveshja e HPEA-së në pajtim me dispozitat e Rregullores (EEC) Nr 2407/92, të specifikuar në Shtojcën I të Marrëveshjes HPEA-së;

“Person që ka të drejtë në kompensim” do të thotë udhëtarët ose cilido person që ka të drejtë të kërkoj lidhur me atë udhëtarë, në pajtim me ligjin e aplikueshëm;

“Bagazh”, përveç në rast se specifikohet ndryshe, do të thotë edhe bagazhi i kontrolluar edhe ai i pakontrolluar në kuptimin e Nenit 17(4) të Konventës së Montrealit;

“DST” do të thotë e Drejtë Speciale për Tërheqje si përkufizohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtarë;

“Konventa e Varshavës” do të thotë Konventa për Unifikimin e Rregullave të Caktuara Lidhur me Transportin Ajror Ndërkombëtar, të nënshkruar në Varshavë më datën 12 Tetor 1929, ose Konventën e Varshavës e ndryshuar në Hagë më datën 28 Shtator 1955 dhe Konventën plotësuese të Konventës e Varshavës së bërë në Guadalajara më datën 18 Shtator 1961;

“Konventa e Montrealit” do të thotë Konventa për Unifikimin e Rregullave të Caktuara Lidhur me Transportin Ajror Ndërkombëtar”, të nënshkruar në Montreal më datën 28 Maj 1999.

“Ministria” do të thotë Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit të Republikës së Kosovës;

“UNMIK” do të thotë Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë;

“Komision” do të thotë Komisioni Evropian;

2. Konceptet që janë të përfshira në këtë Rregullore të cilat nuk janë të përkufizuara në Nenin 2.1 do të jenë ekuivalente me ato të përdorura në Konventën e Montrealit.

### **Neni 3**

1. Përgjegjësia e transportuesit ajror të HPEA-së lidhur me udhëtarët dhe bagazhin e tyre ku Kosova është pike fillestare, pikë e destinacionit apo vend për tu ndalur me marrëveshje, do të rregullohet me të gjitha dispozitat e Konventës së Montrealit që lidhet me përgjegjësinë e tillë .

2. Obligimi për sigurim i përcaktuar me Nenin 7 të Rregullores (EEC) Nr 2407/92 sa i përket përgjegjësisë për udhëtarët do të kuptohet si kërkesë që transportuesi ajror i HPEA-së duhet të sigurohet deri në nivelin që është adekuatë për të siguruar se të gjithë personat që kanë të drejtë për kompensim të pranojnë shumë e plotë të cilën ata kanë të drejtë në pajtim me këtë Rregullore.

### **Neni 3a**

Shuma plotësuese e cila në pajtim me Nenin 22(2) të Konventës së Montrealit, mund të kërkohet nga transportuesi ajror i HPEA-së kur udhëtarët bëjnë deklaratë speciale që interesohen për dërgimin e bagazhit të tyre në një destinacion, duhet të bazohen në tarifata, të cilat ndërlidhen me koston shtesë të përfshirë në transportimin dhe sigurimin e bagazhit në

fjalë, mbi dhe më lartë ato të bagazhit të vlerësuar në ose poshtë limitit të përgjegjësisë. Tarifat do tu vihen udhëtarëve në dispozicion nëse i kërkojnë.

#### **Neni 4**

### **ËSHTË FSHIRË**

#### **Neni 5**

1. Transportuesi ajror i HPEA-së pa vonuar dhe për çdo rast, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pasi identitetit i personit fizik që ka të drejtë për kompensim është përcaktuar, do të bëjë pagesat e avancit ashtu si mund të kërkohej për të plotësuar nevojat e menjëhershme ekonomike në baza proporcionale me vuajtjet e përjetuara.

2. Pa përjashtuar Nenin 5.1, pagesa e avancit nuk do të jetë më e vogël se sa ekuivalent me euro prej 16 000 DST për një udhëtarë në rast të vdekjes.

3. Pagesa avancë nuk do të thotë pranim i përgjegjësisë dhe mund të kërkohej kthimi (kompensohet) i çdo shume të paguar si rrjedhojë në bazë të përgjegjësisë së transportuesit ajror të HPEA-së, mirëpo nuk kthehet, me përjashtim të rasteve të përshkruara në Nenin 20 të Konventës së Montrealit ose kur personi i cili ka pranuar pagesën e avancit nuk ka qenë person me të drejtë kompensimi.

#### **Neni 6**

1. Të gjithë transportuesit ajror, gjatë shitjes së transportit ajror në Kosovë, duhet të sigurojnë se një përmbledhje e shkurt e dispozitave kryesore që rregullojnë përgjegjësinë për udhëtarë dhe bagazhin e tyre, përfshirë afatet e fundit për përmbushjen e një veprimi për kompensim dhe mundësia e bërjes së një deklarate speciale për bagazh, u është vënë në dispozicion udhëtarëve në të gjitha pikat e shitjes, përfshirë shitjen përmes telefonit dhe përmes Internetit. Në mënyrë që të veprojnë në përputhje me këtë kërkesë për informacione, transportuesit ajror të HPEA-së duhet të përdorin njoftimin e bashkangjitur në Shtojcën e kësaj Rregullore. Përmbledhja ose njoftimi i tillë nuk mund të përdoret si bazë për ankesë për kompensim, e as të interpretojnë dispozitat e kësaj Rregullore e as Konventën e Montrealit.

6.2 Përveç kriteriumit për informim të përcaktuar në Nenin 6.1, të gjithë transportuesit ajror që kanë të bëjnë me transportin ajror të ofruar ose të blerë në Kosovë, do t'ia sigurojnë secilit udhëtarë një njoftim me shkrim për:

- limitin e aplikueshëm në atë fluturim për përgjegjësinë e transportuesit lidhur me vdekjen ose lëndimet, nëse limitet e tilla ekzistojnë,

- limitin e aplikueshëm në atë fluturim për përgjegjësinë e transportuesit lidhur me shkatërrimin, humbjen ose dëmtimin e bagazhit dhe paralajmërimin se bagazhi me vlerë më të lartë se në këtë foto duhet të lajmërohet kompania ajrore në hyrje (check-in) ose të sigurohet plotësisht nga udhëtari para se të udhëton;

- limitin e aplikueshëm në atë fluturim për përgjegjësinë e transportuesit për dëmet e shkaktuara nga vonesat.

3. Në rast se i gjithë transporti i kryer nga transportuesit ajror të HPEA-së, limitet e shënuara në pajtim me kriteriumet për informim të Nenit 6.1 dhe 6.2 do të jenë ato të përcaktuara me këtë Rregullore, përveç nëse transportuesi ajror aplikon limite më të larta në baza vullnetare. Në rast se i gjithë transporti kryhet nga transportues ajror jo nga HPEA, Neni 6.1 dhe 6.2 do të aplikohen vetëm në relacionin e transportit për në, nga ose përbrenda Kosovës

### **Neni 7**

Në pajtim me Nenin 7 të Rregullores (EC) Nr 2027/97 e ndryshuar me Rregulloren (EC) Nr 889/2002, Komisioni do të ekzaminon nevojën për të reviduar shumat e përmendura në nenet përkatës së Konventës së Montrealit në frymën e zhvillimeve ekonomike dhe të njoftimeve nga Thesari i ONAC-it.

### **Neni 8**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datën 20/Nëntor/2008.

Fatmir Limaj

Datë:03/Nëntor/2008

---

Ministër i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit

## **SHTOJCA**

### **Përgjegjësia e transportuesit ajror për udhëtarët dhe bagazhin e tyre**

Ky njoftim përmbledh rregullat për përgjegjësinë që aplikohen nga transportuesit ajror të HPEA-së si kërkohet me Marrëveshjen e HPEA0së dhe Konventën e Montrealit.

### **Kompensimi në rast vdekje ose lëndimi**

Nuk ekziston asnjë limit financiar për përgjegjësinë për lëndimin apo vdekjen e udhëtarit. Për dëmet deri në 100 000 DST (përafërsisht 110 000 Euro) transportuesi ajror nuk mund të kontestojë ankesat për kompensim. Mbi këtë shumë, transportuesi mund të mbron vetveten kundër ankesës për kompensim duke dëshmuar se nuk ka qenë neglizhent apo përndryshe nuk ka gabuar.

### **Pagesat në avancë**

Nëse udhëtari vritet apo lëndohet, transportuesi ajror duhet të bën pagesa në avancë, për të mbuluar nevojat e menjëhershme ekonomike, brenda 15 ditëve nga identifikimi i personit që ka të drejtën e kompensimit. Në rast vdekje, kjo pagesë e avancit nuk do të jetë më e vogël se 16 000 DST (përafërsisht 17 600 Euro).

### **Vonesat e udhëtarëve**

Në rast të vonimit të udhëtarit, transportuesi ajror është përgjegjës për dëmin përveç nëse ka ndërmarr të gjitha masat e arsyeshme për të shmangur dëmin ose ka qenë e pamundshme të ndërmerren masat e tilla. Përgjegjësia për vonesën e udhëtarit është e kufizuar në 4 150 DST (përafërsisht 4 560 Euro).

### **Vonesat e bagazhit**

Në rast të vonimit të bagazhit, transportuesi ajror është përgjegjës për dëmin përveç nëse ka ndërmarr të gjitha masat e arsyeshme për të evituar dëmin ose ka qenë e pamundshme të ndërmerr masat e tilla. Përgjegjësia për vonesën e bagazhit është e kufizuar në 1 000 DST (përafërsisht 1 100 Euro).

### **Shkatërrimi, humbja ose dëmtimi i bagazhit**

Transportuesi ajror është përgjegjës për shkatërrimin, humbjen ose dëmtimin e bagazhit deri në 1 000 DST (përafërsisht 1 100 Euro). Në rast se bagazhi është regjistruar, është përgjegjës madje edhe nëse nuk është faji i tij, përveç nëse bagazhi ka qenë me defekte. Në rast se bagazhi nuk ka qenë i regjistruar, transportuesi është përgjegjës vetëm nëse ka qenë faji (gabimi) i tij.

### **Limite më të larta për bagazhin**

Udhëtari mund të përfiton nga limitet më të larta të përgjegjësisë duke bërë një deklaratë special më së voni gjatë regjistrimit (check-in) dhe duke paguar një pagesë shtesë.

### **Ankesat për bagazhin**

Nëse bagazhi është dëmtuar, vonuar, humbur ose shkatërruar, udhëtari duhet të shkruan dhe bën ankesë tek transportuesi ajror sa më parë e mundshme. Në rast se është dëmtuar bagazhi i regjistruar, udhëtari duhet të shkruan dhe ankohen brenda shtatë ditëve dhe në rast të vonës brenda 21 ditësh, në të dy rastet nga data në të cilën bagazhi është vënë në dispozicion të udhëtarit.

### **Përgjegjësia për kontraktim dhe e transportuesve aktual**

Nëse transportuesi ajror që aktualisht kryen fluturimin nuk është i njëjtë me transportuesin ajror të kontraktuar, udhëtari ka të drejtë të adresoj një ankesë ose të bën një kërkesë për dëme kundër që të dyve. Nëse emri ose kodi i transportuesit ajror është i shënuar në biletë, ai transportues ajror është transportuesi ajror i kontraktuar.

### **Limit kohor për veprim**

Çdo veprim në gjykatë për të kërkuar dëmet duhet të bëhet brenda dy viteve nga data e arrijtes së avionit, ose nga data në të cilën avioni është dashtë të arrijë.

### **Bazat për informata**

Bazë për rregullat e përshkruara më lartë është Konventa e Montrealit të datës 28 Maj 1999, që është implementuar në Ligjin mbi Aviacionin Civil të Kosovës (Ligji Nr. 03/L-051) të datës 13 Mars 2008 dhe Rregulloren 2008/4 [*Koment i ZRRAC-it: kjo Rregullore*].